REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 862/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.862/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik "Amazona Hotel "SH.P.K, & "Faton Haziraj B.I",-Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.T.P "Global Parajsa"-Vushtrri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së Ri-tender vazhdim afati" me nr. të prokurimit: 214-19-4346-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Akademia e Kosovës për Siguri Publike", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si pjesërisht e bazuara ankesa e operatorëve ekonomik: "Amazona Hotel "SH.P.K, & "Faton Haziraj B.I",-Obiliq, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së Ri-tender vazhdim afati" me nr. të prokurimit: 214-19-4346-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Akademia e Kosovës për Siguri Publike".

II. <u>VËRTETOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës i AK-së për aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së Ri-tender vazhdim afati" me nr. të prokurimit: 214-19-4346-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Akademia e Kosovës për Siguri Publike".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Amazona Hotel "SH.P.K, & "Faton Haziraj B.I"-Obiliq, aprovohen pjesërisht si të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "Amazona Hotel "SH.P.K. & "Faton Haziraj B.I"-Obiliq, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 29.10.2020 me nr. 862/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së Ri-tender vazhdim afati" me nr. të prokurimit: 214-19-4346-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Akademia e Kosovës për Siguri Publike", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 56, 59, 60, 69 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 30.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 09.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Eksperti shqyrtues konstaton se pas sqarimeve të kërkuara, AK-së e eliminuar OE ankues "AMAZONA HOTEL SH.P.K & FATON HAZIRAJ B.I", me arsyetimin i cili shihet më poshtë:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

1.Kompania „Amazona Hotel''shpk & Faton Haziraj B.I. nuk i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit,njoftimin për kontratë si në vijim: **në dosjen e tenderit , njoftimin për kontratë është kërkuar**

9.1& 9.2(Kapacitetet teknike profesionale) nr.11
O.E. duhet të dëshmoj stafin profesionalmin 4 kuzhinjerë (2 nga kuzhinjeret të jenë të kualifikuar diploma dhe 2 për gjellëbërës)në fushën e gastronomisë dhe min një (1) inxhinjer të diplomuar të teknologjisë së ushqimit master apo bachelor.

Dëshmi e kërkuar dokumentare nr.11.
Listen e stafit profesional e vulosur dhe nënshkruar nga O.E. duke ofruar dëshmi për secilin kuzhinjer dhe gjellëbërës dhe ingjinjer të teknologjisë ushqimore .Kopjet e diplomave për kuzhinjer, për gjellëbërës, dhe për inxhinjer, CV,kopja e kontratave të punës ose ose para kontrata me emër të projetit në fjalë.

Lista e stafit që ka ofertuar Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI " i mungojnë dy (2) gjellëbërsa me diplomë,CV,kontrata e punës.
Duke pasur parasysh që kërkesa e AK-së në dosjen e tenderit ka qenë shumë e qartë që të dëshmohet me diploma DY GJELLËBËRËS ka të bëjë me rastin se në kuzhinën tonë në AKSP 90% e ushqimit janë gjella dhe kjo ka qenë edhe arsyeja e kërkeses tonë pasi që ne nuk kemi këtu HOTEL me yje që na duhen vetem kuzhinjer ,mirpo kuzhinjer kemi kërkuar për raste kur kemi takime specifike dhe dreka zyrtare të nivelit më të lartë si psh .OSCE,

Ambasada të ndryshme në vizitë, vizita nga qeveria , USAID, trajnime të ndryshme regjionale etj.
Dy nga ofertuesit tjerë kanë pasur gjellëbërës me diploma të lëshuar nga institucionet e Republikes së Kosovës .

2. 13. Operatori ekonomik duhet të ofroje listen per kontratat të natyrës se njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, në rastë të konzerciumit Lideri duhet të kete kontrata të shërbime së paku 60% te vleres të shërbimeve te kerkuara (shërbime- përgatitje dhe servime te ushqimit), me institucione publike apo privat gjate tre (3) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum ne vlere min 950,000.00 € .

13. Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të natyrës se njëjtë në fushën e sherbimeve - gastronomisë, gjate tri viteve te fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, minimum tri rerefernca pozitive duke ju bashkangjitur listes se kontratave. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, Ne rast konzerciumi lideri duhet ti ket ne emer te OE referencat me vler 60% te dëshmuara me referenca te suksesshme, në kopje në rast konzerciumi, të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse , për shërbimet e pranuara , te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës , natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve. a. Kur shërbimimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë. b. Kur shërbimimi është bere për një blerës privat, duhet te dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve)te lëshuara nga blerësi i tille. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve te shërbimeve.

Lista e referencave që ka ofertuar Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit .
Referenca e cekur në listë e referencave me OSCE me vlerë 116.888.70 pas kërkeses sonë për sqarime me datë 24.09.2020 (pasi ka qenë nga viti 2014) kemi kërkuar të na sjell pagesat apo transferet bankare , faturat për tri vitet e fundit (qeshor 2016- qeshor 2019) nuk na ka sjell fare, dhe ka mospërputhshmëri(diskrepancë) njëra me tjetren në shumë .OE që ka ofertu në ofertë elektronike vlera e references është 116.888,70 euro ndërsa kur kemi kërkuar sqarim për referncë për vërtetitshmërinë na ka dërguar në mënyr elektronike dhe fizike me shumë tjeter 116.88,70 euro kjo referencë për AK-në është e pa pranushme dhe e manipuluar.

Referenca e lëshuar nga organizata joqeveritare PEN me vlerë 108,316.50 nuk është e pranushme për AK pasi pas sqarimeve qe ju kemi drejtuar kesaj Organizate me datë 24.09.2020 z. Bujar Fejzullahu nuk është përgjigjur fare.

Gjithashtu ne si AK kemi kërkuar sqarim me datë 24.09.2020 lidhur me referencën që ka prezentuar në listën e referencave ne vlere 52,767.00 nga firma Apetiti shpk të na deshmoj me transfere bankare apo me fatura lidhur me këtë referencë ka refuzuar me dëshmu,por na shkruar në e-mail se në Kosovë referencë bënë edhe ndrrimi MALL me MALL e ku Ligji i Prokurimit nuk e njeh një të tillë dhe janë të papranueshme referncat e tilla.

Referenca e prezentuar në listen nga NEËCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C me vlerë 1,049,615.00 pas kërkesës së sqarimeve me datë 24.09.2020 që të na dëshmojë me faturë apo me transfer bankar ky OE nuk është përgjigjur fare.

Referenca Instituti Demokracia për Zhvillim ne si AK kemi kërkuar sqarim me datë 24.09.2020 të na informon lidhur me referencen në vlerë 24.320,00 euro nuk kemi marr asnjë përgjigjje dhe pas sqarimeve qe kemi kërkuar për verifikim nuk janë të njëjta referencat dhe kan mospërputhshmëri (diskrepancë) njëra me tjetren kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme dhe e manipuluar.

Referneca nga Ministria e Bujqësisë në vlerë 26.720,00 euro kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigjje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme .

Referneca nga Emona shpk kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigjje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme .

Refreneca nga Pestova shpk kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigjje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme .

Referneca nga OJQ LËVIZJA KOHA kemi kërkuar sqarime shtesë me datë 24.09.2020 dhe nuk kemi marrë asnjë përgjigjje nga ata dhe kjo referencë për AK-në është e pa pranueshme .

Gjithashtu edhe për referencat tjera që ju kemi shruar më heret nuk na ka dëshmu që ka kryer shërbime të ushqimit pas kërkesës sonë në bazë të nenit 72 për shumën e paraqitur në referencë .

Konkluzioni përfundimtar i AKSP-së lidhur me referencat e konzorciumit Amazona Hotel & Faton Haziraj B.I nuk e kanë përmbushë listen referencave për tri vitet e fundit (950,000.00) dhe as lideri 60% të totalit por as patneri siq e ka qenë e kërkuar ne dosjen e tenderit.

3.Mungojnë raportet (transakcionet) e pagesave nga banka për listat e kontratave të realizuara për tri vitete e fundit që ka qenë kërkesë e letres standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit sipas nenit 72 të LPP-së.

4. 14. OE duhet te ofroj dëshmi

- Automjet i mbyllur min 2 copc.ne emer te OE

Dëshmitë e kërkuara dokumentuara

14. Lista e mjeteve Dëshmitë

- Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje

Operatori Ekonomik „Amazona Hotel & Faton Haziraj BI nuk e përmbush këtë kriter sipas dosje së tenderit pasi që të gjitha automjetet janë pronë e kompanisë „APETIT shpk" dmth nuk janë në pronsi të Amazona Hotel.

Sai përket kërkesës për automjete OSHP-ja ka vendime të lëshuara që vetëm që ska qenë automjeti i rexhistruar e keni eliminuar operatorin ekonomik e lëre që me rastin tonë operatori ekonomik i mungojnë dy automjete.

Përgjigje në Pretendimi nr. 1

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "OE duhet të dëshmoj stafin profesional min 4 kuzhinierë (2 nga kuzhinieret të jenë të kualifikuar Diploma dhe 2 për gjellëbërës) ne fushën e gastronomisë dhe min 1 Inxhinier të Diplomuar te teknologjisë se ushqimit Master apo Bachelor". Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: "Listën e stafit profesionale vulosur dhe nënshkruar nga OE, duke ofruar dëshmi për secilin kuzhinier dhe gjellëbërës dhe Inxhinier te Teknologjisë Ushqimore . Kopjet e Diplomave për Kuzhinier, për Gjellëbërës dhe për inxhinier, CV, kopja e kontratave të punës ose para kontrata me emër te projektit në fjale". Operatori ekonomik ankues N.T.P "AMAZONA

HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", me ankesë ka ofruar një dëshmi ku ju ka drejtuar me një kërkesë për sqarim QENDRËS KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Republikës së Kosovës, e cila qendër i kanë kthyer përgjigje: "Natyrisht që titulli Gjellëbërës hynë në kategorinë e diplomës për Kuzhinier", shih më poshtë komunikimin dhe përgjigjen.

Kërkesë ,Drejtuar: Qendres Kombetare per Njohje/Barasvlere dhe Informim Akademik (NARIC)

Inbox

Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>
to Kumrije

z. Kumrije Gagica, Udheheqese e Qendres Kombetare per Njohje dhe Informim Akademik

Si Qender pergjegjese per Njohje dhe Informim Akademik, ju drejtohem me kerkesen qe te me jepni nje sqarim pak me te zgjeruar se titullu gjelleres a hyn ne kategorine e q
Nje pergjigje e juaj si Qender Kompetente do te na ndihmone te shume per ti sqaruar disa paqartesi ne lidhje me nje tender qe eshte ne procedure te avancimit
Me respekt

Amazona Hotel
Phone: +38344197419 , +38349454454
Website: www.hotelamazona.com

Kumrije Gagica <kumrije.gagica@rks-gov.net>
to me

Te nderuar,

Ndjese per vonesen ne pergjigje. Natyrisht qe edhe titulli gjelleres hyn ne kategorine e diplomes per "kuzhinier".

Me respekt,
Kumrije Gagica
Udheheqese ne NARIC Kosova

On 24 Aug 2020, at 11:34 AM, Hotel Amazona <info@hotelamazona.com> wrote:

Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesë e njoftimit për kontratë dhe në dosjen e tenderit është: *"(2* nga kuzhinieret të jenë të kualifikuar Diploma dhe 2 për gjellëbërës)". Pas analizimit të dëshmive të ofruara në dosjen e tenderit, dëshmive të ofruara në letrën sqaruese, si dhe duke u bazuar në sqarimin e ofruar nga OE ankues, të bërë QENDRA KOMBËTARE PËR NJOHJE TË DIPLOMAVE pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Republikës së Kosovës, i cili sqarim është i cekur në ankesë, mund të merret i mirëqenë ky sqarim. Paneli shqyrtues Vendimin PSH. nr 475/20, të dt:21.08.2020, këtë pikë e ka ka arsyetuar, për më tepër referoju dëshmisë më poshtë:

> Paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e njoftimit për kontratë dhe në dosjen e tenderit është: "(2 nga kuzhinieret të jenë të kualifikuar Diploma dhe 2 për gjellëbërës)". Pas analizimit të dëshmive të ofruara në dosjen e tenderit, dëshmive të ofruara në letrën sqaruese, si dhe duke u bazuar në pretendimin (sqarimin) e OE ankues të cekur në ankesë, paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti kontraktues konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së duhet të kërkoj sqarime shtesë dhe të bëjë verifikimin/ klasifikimin e certifikatave (diplomave) të kuzhinierëve dhe gjellëbërëseve konform ligjit Nr. 04/L-138 për arsimin dhe aftësimin profesional, ligji për arsimimin e mesëm dhe certifikimet dhe Udhëzimet administrative relavante të aprovuara nga MASHT, në mënyrë që të dëshmohet se a e mbulon diploma e kuzhinierit edhe certifikimin për gjellëbërës, andaj paneli shqyrtues e konsideron si te qendrueshem pretendimin ankimor dhe njekohesisht vlereson se AK gjate rivleresimit te sqaroj kete pike ne lidhje me kuzhinieret dhe gjelleberesit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 2

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofroje listën për kontratat të natyrës se njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, në raste të konzerciumit Lideri duhet të këtë kontrata të shërbime së paku 60% të vlerës të shërbimeve të kërkuara (shërbime- përgatitje dhe servime te ushqimit), me institucione publike apo privat gjate tre (3) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum në vlerëë min 950,000.00 €" .Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të natyrës se njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, gjate tri viteve te fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, minimum tri referenca pozitive duke ju bashkangjitur listës se kontratave. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, Ne rast konzerciumi lideri duhet ti ketë në emër të OE referencat me vlerë 60% të dëshmuara me referenca te suksesshme, në kopje në rast konzerciumi, të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse, për shërbimet e pranuara, te cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve. a. Kur shërbimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë. b. Kur shërbimi është bere për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga blerësi i tille. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve të shërbimeve".

Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë me dt:24.09.2020, nga OE ankues NTP "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", për referencat e cekura tek Letra standarde për tenderuesin e eliminuara, ku deklaron se nuk ka marrur asnjë sqarim, këto referenca për të cilat AK-së, deklarohet se ka kërkuar sqarime shtesë dhe për të cilat nuk ka marrur sqarime shtesë janë të prezantuar si dëshmi më lartë. Operatori ekonomik ankues NTP "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", deklaron se AK-së gjatë vlerësimit herën e parë dhe sqarimit të tenderëve na ka kërkuar që të ia dërgojmë në kopje fizike të gjitha dëshmitë që i kemi dorëzuar si të skanuara në tenderin tonë. Disa prej dëshmive kemi hezituar të ja dërgojmë sepse janë materiale shumë sensitive (diploma të viteve para 1999) dhe në rast të dëmtimin apo humbjes së tyre, mundësia e pajisjes prapë me të tilla është zero. Pavarësisht kësaj ne ia kemi ofruar si origjinale në shikim ndërsa si të noterizuara në posedim, por Zyrtari Kryesor i Prokurimit (ZKP) si duket nuk u mjaftuaka me kaq. Përpos kësaj prapë ka kërkuar nga disa kompani që ne kemi pasur referencat e tyre mbi realizimin me sukses të projekteve e që i kemi paraqitur edhe në listën e kontratave ku nga to ka kërkuar transaksione bankare, fletëpagesa dhe dëshmi të ngjashme edhe pse këto nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit. Bazuar në këtë OE ju ka drejtuar KRPP-së me një kërkesë për interpretim, dhe këtë interpretim e ka ofruar si dëshmi, ku ndër të tjera thuhet se:

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nen-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si në vijim:

Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-se përcakton:

"3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të lartcekur, në asnjë mënyrë AK nuk i lejohet të diskualifikojë ndonjë OE për ndonjë dëshmi që nuk është specifikuar në dokumentet e tenderimit.

Për të gjithë operatorët ekonomik që pretendojnë se AK nuk ka bërë vlerësimin e tendereve në përputhje me kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit, si dhe në përputhje me dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor, LPP ka paparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Me respekt,
Arbnora Cakolli-Luzha,|
Kordinatore e Departamentit te Rregullave-KRPP.

Po ashtu nga OE ankues N.T.P "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", me dt:03.07.2020, është bërë kërkesë për Interpretim tek KRPP, shih interpretimin më poshtë:

Gmail

Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>

Kerkese per interpretim te kerkeses per sqarim nga AK - parashtruar nga AMAZONA HOTEL SHPK

Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>
To: Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>

Wed, Jun 3, 2020 at 10:43 AM

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nen paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor si në vijim:

Sipas nenit 59 të LPP-se, vlerësimi i tenderëve eshtë kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-se, ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*** *Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa eshtë e mundshme, dhe te merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".*

Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-se përcakton:

"3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk eshtë i cekur ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 te lartcekur, në asnjë mënyrë AK nuk i lejohet të diskualifikoje ndonjë OE per ndonjë dëshmi që nuk eshtë specifikuar në dokumentet e tenderimit.

Në përputhje me paragrafin 7 te nenit 52 te LPP-se, *"Autoriteti kontraktues ne rast te dyshimit te cilitdo informacion te dorëzuar nga operatori ekonomik, do te kryej një kontroll efektiv te informatave dhe dokumentacionit te tenderit".*

Bazuar ne dispozita e lartcekura, per tu konsideruar një tender i pergjegjshem tenderi ne fjale duhet te jete ne perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate. Ne rast se gjate procesit te vleresimit, AK konstaton se OE nuk ka ofruar ndonje deshmi ne perputhshmeri me ate qe eshte kerkuar ne dokumentet e tenderimit, ka te drejte qe ne perputhshmeri me paragrafin 2 te nenit 59 dhe nenin 72 te LPP-se te kerkoje sqarime me shkrim nga OE, dhe ne rast se dyshon ne ndonje informacion te dorezuar ka te drejte te kryej nje kontroll efektiv te dokumentacionit te tenderit.

Paneli shqyrtues për këtë pikë në vendimin PSH. nr 475/20, të dt:21.08.2020, i ka dhënë këto sqarime, shih më poshtë:

Siç shihet në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dëshmi janë kërkuar të dorëzohen Certifikata e pranimit ose referenca, mirëpo në nenin 59.2 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues", dhe duke pasur parasysh Interpreteimin e ofruar nga Rregullat KRPP ku thuhet se AK mund të kërkoj sqarime shtesë, dhe të bëjë verifikimin e vërtesisë se dokumenteve të ofruara, tek operatori ekonomik, mirepo sipas paragrafit 3 të nenit 56 të LPP-së "3.Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", paneli shqyrtues obligon AK që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtese dhe të bazohet vetem në kërkesen e dosjes së tenderit të specifikuar nga ata, dhe më këtë rast të bëjë verifikimin e vërtetsisë së dokumenteve të ofruara nga OE ankues, nëse ka dyshime në to.

Eksperti shqyrtues sqaron se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit tek pika b. është kërkuar të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga blerësi i tille. Siç shihet në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dëshmi janë kërkuar të dorëzohen Certifikata e pranimit ose referenca. Në nenit 59.2 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". Duke pasur parasysh që referencat e ofruara nga OE ankues, ku një pjesë janë më të vjetra se tri vite, përfshirë periudhën e njoftimit për kontratë, si dhe një numër i këtyre referencave përveç ushqimit kanë të bëjnë me akomodim në dhoma të Hotelit. Bazuar në Interpretimet e dt:03.07.2020, të bërë nga KRRP-ja, i cili interpretim është kërkuar nga OE ankues NTP "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", pjesa e fundit e interpretimit të KRPP-së, është bërë duke u thirrur në paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së. Interpretimi ndër të tjera thekson: "AK-së në rast se dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar, ka të drejtë të kryej një kontrolle efektivë të dokumentacionit të tenderit".

Mund të konkludojmë se AK-së, kur ka kërkuar sqarime shtesë për Referencat e cekura më lartë ka vepruar konform neneve 59 dhe 72 të LPP-së, dhe pa sqarimin e këtyre referencave OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit min e vlerës prej 950,000.00€, si dhe 60% të referencave si lider i konsorciumit. Andaj bazuar në Vendimin PSH.nr 475/20, të dt:21.08.2020, ku krejt në fund Paneli shqyrtues obligon AK-

së, që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, të dhëna në konstatime sipas pretendimeve. Pra siç shihet AK-së, i ka kërkuar sqarime shtesë për pretendim, siç ishin Diplomat e Kuzhinierëve dhe Kontratave dhe referencave të ofruara nga OE ankues.

Përgjigje në Pretendimi nr. 3

Eksperti shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: OE duhet të ofroj dëshmi: • Automjet i mbyllur min 2 cope. në emër të OE. • Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 6 cope për ushqime. Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: Lista e mjeteve Dëshmitë

• Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje

• Fotografit me përshkrim të pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje. Eksperti shqyrtues sqaron se OE "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e pajisjeve, ku në këtë listë janë gjithsejtë gjashtë (6) pajisje, me libreza të regjistrimit, si dhe kontratën mbi dhënien e automjeteve me qira, të lidhur me 01.06.2019, në mes me "APETIT SH.P.K" dhe "AMAZONA HOTEL SH.P.K", dhe të gjitha këto pajisje janë të pronësi të "APETIT SH.P.K". Për më tepër shih dëshmitë e ofruara më poshtë:

EVIDENCA E AUTOMJETEVE

EMERTIMI I SUBJEKTIT "AMAZONA HOTEL" SH.P.K.

NUMRI UNIK IDENTIFIKUES I SUBJEKTIT 810129157

Nr.	Regjistrimi	Tipi	Shasia	Data vallë e regjistrimit
1.	02-168-BO	Furgon Frigo 4 Dyer	WDB9066331S254695	03.04.2020
2.	676-KS-677	Furgon Frigo 7 Dyer	WDB9702771L179370	14.05.2020
3.	02-439-DC	Furgon Frigo 4 Dyer	WV1ZZZ7HZ5H062803	25.06.2020
4.	02-445--DC	Furgon Frigo 4 Dyer	WV1ZZZ7HZ5H018450	26.06.2020
5.	02-287-BO	Furgon Frigo 5 Dyer	WDB9066331S420445	26.05.2020
6.	02-510-BO	Furgon Frigo 1 Dyer	WV1ZZZ2KZCX003470	10.07.2020
7.				

Gjithashtu këto pajisje janë të cekura te Kontrata mbi dhënien e automjeteve me qira, shih dëshminë:

KONTRATË MBI DHËNIEN AUROMJETEVE ME QIRA

Nr.Kontrates: 06/2019

E lidhur më datën: 01.06.2019 në mes të palëve kontraktuese: APETIT SHPK, nr. unik identifikues: 811106823, Magjistralja Prishtinë-Mitrovicë, Km-1 si qiradhënës, të cilën e përfaqëson Destan Ferizi dhe Amazona HOTEL, Nr. unik identifikues : 810129157, Babimoc-Obiliq të cilën e përfaqëson Gani Ferizi, si qiramarrës dhe atë si vijonë:

I

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e gjashtë (6) automjeteve – Furgon Frigo me te dhënat të cekura me poshtë:

1.Automjet: Daimler Chrysler, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2008, WDB9066331S254695
2.Automjet: Mercedes-Benz, Tipi: Kamion Frigo, Viti: 2006, WDB9702771L79370
3.Automjet: VW, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2005, WV1ZZZ7HZ5H062803
4.Automjet: VW, Tipi: Furgon Frigo, Viti: 2004, WV1ZZZ7HZ5H018450
5.Automjet: Mercedes-Benz, Tipi: Furgon Frigo 2009, WDB9066331S420445
6.Automjet: VW, Tipi: Kombi Frigo 2012, WV1ZZZ2KZCX003470

Paneli shqyrtues në Paneli shqyrtues në vendimin PSH.nr 475/20, të dt:21.08.2020, krejt në fund i ka dhënë këto sqarime, shih më poshtë:

> **Në lidhje me arsyen e tretë** të eliminimit paneli shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: OE duhet të ofroj dëshmi- Automjet i mbyllur min 2 cope në emër të OE dhe Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 6 cope për ushqime, ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: Lista e mjeteve Dëshmitë- Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje dhe Fotografitë me përshkrim të pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje. Paneli shqyrtues sqaron se OE "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e pajisjeve, ku në këtë listë janë gjithsejtë gjashtë (6) pajisje, me libreza të regjistrimit, si dhe kontratën mbi dhënien e automjeteve me qira, të lidhur me 01.06.2019, në mes me "APETIT SHPK" dhe "AMAZONA HOTEL SHPK", dhe të gjitha këto pajisje janë të pronësi të "APETIT SHPK". Sipas nenit 69.4.5 të LPP-së, kërkesën për pajisjet e kërkuara në dosjen e tenderit, OE munden ta plotësojnë duke dorëzuar: raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike që janë në dispozicion të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve. Poashtu sipas nenit 69.8 të LPP OE munden, kur është e përshtatshme dhe për një kontratë të veçantë, të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, pa marrë parasysh natyrën ligjore të lidhjeve që ajo ka me ta, andaj paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit ta sqarojë këtë pikë konform nenit 72 të LPP-së.

> Paneli shqyrtues konstaton se AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin e tenderëve konform nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues obligon AK-në që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së në të gjitha pikat të dhëna në konstatime sipas pretendimëve ankimore. Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit do të veproj në harmoni me nenin 1 dhe 7 të LPP-së dhe në harmoni me dispozitat e cekura si më lartë.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet "Automjet i mbyllur min 2 cope. në emër të OE", operatori ekonomik ankues NTP "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit, sepse automjetet janë në emër të "APETIT SHPK", ndërsa është kërkuar të jenë në emër të OE, askund nuk është kërkuar që automjetet të merren në huazim. Po ashtu në lidhje me këtë kriter OE në fjalë ka mundur të bëjë ankesë gjatë fazës së tenderimit.

Përgjigje në Pretendimi nr. 4

Operatori ekonomik ankues NTP "AMAZONA HOTEL SHPK & FATON HAZIRAJ B.I", deklaron se me vet faktin se në dosjen e tenderit të publikuar në e-prokurim herën e parë tek deklarata nën betim e ka vendosur vet emrin e OE "Global Parajsa", nënkupton se përgatitjen e tenderit e kanë bërë së bashku me këtë

OE e që në kushte normale do të ishte argument i mjaftueshëm për hetim të bashkëpunimit të tyre. Dëshmia që e ka ofruar OE, ku pretendon se ndodhet në dosjen e tenderit të publikuar më 11.09.2019 nga AK-ja:

Numri i prokurimit: 214/19/09/211-Titulli: Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së-ritender

Aneksi 2. **DEKLARATA NËN BETIM**

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [*Ntp Global Parajsa*] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Eksperti shqyrtues sqaron se në e-prokurim ekzistojnë dy dosje të tenderit, njëra e ka dt:04.02.2020, ora 11:13, dhe tjetra e ka dt:04.05.2020, ora 12:25.

Dokumenti shtojca

Versioni i tanishëm: 24.02.2020 11:13 Dosja e RiTenderit - shqip.doc

Hape: English Word dokumenti

Dosja e Tenderit

Versioni i tanishëm: 04.05.2020 12:25 Dosja e RiTenderit - shqip (11).doc

Word dokumenti

Emir NTP "GLOBAL PARAJSA", tek Deklarata nën Betim, është i shënuar në Dokumentin shtojca, e dt: 24.02.2020, ndërsa tek Dosja e Tenderit të dt. 04.05.2020, nuk ekziston emri dhe mendoj se ky pretendim nuk ka të bëjë me kritere kualifikuese, si dhe ky pretendim nuk ka qenë në periudhat e më hershme. Ndërsa sa i përket pretendimit se në Deklaratën nën betim, AK-së e ka vendosur vet emrin e OE "Global Parajsa", e ku nënkuptohet se përgatitjen e tenderit AK-së e ka bërë së bashku me këtë OE, e që në kushte normale do të ishte argument i mjaftueshëm për hetim të bashkëpunimit të tyre, mendoj se kjo çështje ka mundur dhe mund të adresohet në organet kompetente që merren me këto punë, pra kjo nuk bije në domenin e kompetencave të mija.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 09.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 13.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Gjithashtu AK me date 27.11.2020 njofton OSHP-ne si me poshtë:

From: Bekim Dakaj <Bekim.Dakaj@rks-gov.net>
Sent: 27/Nov/20 11:51
To: Blerim Dina <Blerim.Dina@rks-gov.net>; Nuhi Paqarizi <Nuhi.Paqarizi@rks-gov.net>; Goran Milenkovic <Goran.Milenkovic@rks-gov.net>
Subject: Njoftim
Përshëndetje të nderuar,
Për informimin tuaj,
Po ju njoftoj lidhur me kërkesën që e ka bërë Aurotiteti Kontraktues (AKSP-ja) për vazhdimin e validitetit të ofertës për të gjithë operatoret ekonomik që kanë marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me titull „Shërbimet e përgaditjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP ritender vazhdim afati me numer të prokurimit 214/19/09/211 & 214/19/4346/211 ku operatori ekonomik ankues „Amazona Hotel shpk & Faton Haziraj B.I. nuk është përgjigjur brenda afatit kohor që e ka bërë kërkesën AK-ja por e ka dërguar vazhdimin në mënyrë elektronike mbas 10 dite dmth me 23.11.2020 si dhe në deklaratën e ka lëshuar të nënshkruar dhe vulosur me datë 13.11.2020 ku bjen ndesh me kërkesën e AK-së.
Të bashkangjitur gjeni dokuntacionin përkatës.
Ju lutem na konfirmoni e-mailin e pranuar.
Me respekt
Bekim Dakaj
Menaxher i Divizionit të Prokurimit - Manager of Procurement Division
Akademia e Kosovës për Siguri Publike - Kosovo Academy for Public Safety
Rr./Str. Gjergj Kastrioti Skënderbeu p.n./n.n.
42000 Vushtrri
Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Tel: +383 (0)28 590 070 ext. 280
E-mail: bekim.dakaj@rks-gov.net
Web: http://aksp.rks-gov.net

Operatori Ekonomik: "Amazona Hotel" SH.P.K,-Obiliq, me datë: 12.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk-pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Të nderuar/a,Me këtë letër dhe në emër të Grupi i OE "AMAZONA HOTEL SHPK & Faton Haziraj B.I." dua të ju konfirmoj se kemi pranuar ekspertizën e Ekspertit Shqyrtues me numër 862/20 të datës 09.11.2020 të cilën e KUNDËRSHTOJMË në tërësi dhe njëherit kërkojmë nga OSHP që para organizimit të seancës të i kërkoj Ekspertit Shqyrtues që ta bëjë edhe njëherë shqyrtimin e komplet ankesës bazuar plotësisht në LPP dhe në faktet e ofruara nga ne. Sipas Ekspertit Shqyrtues ankesa jonë nënkupton se është e pabazuar edhe pse në asnjërin nga pretendimet nuk e ka cekur se a është e bazuar apo jo pretendimi jonë. Në fund fare ka deklaruar se ankesa është pjesërisht e bazuar ku ne nuk mund ta kuptojmë detalisht se cili nga

pretendimet është bazuar e cili jo. Mënyra se si ju ka qasur eksperti shqyrtues trajtimit të ankesës tonë është plotësisht në kundërshtim me Rregulloren e punës së OSHP-së, është në kundërshtim me LPP-në dhe me RRUOPP. Përpos kësaj është në kundërshtim edhe me interpretimet e KRPP-së që janë të lëshuara ekskluzivisht për këtë rast si dhe është në kundërshtim me vendimin e kaluar të OSHP-së ku pretendimet e pranuara si të bazuara nga Paneli Shqyrtues, tash eksperti i hedh si të pabazuara. Kjo është krejtësisht e papranueshme sepse zakonisht OSHP e ruan konsistencën e trajtimit të pretendimeve dhe çdo here bazohet në praktikat e përdoruara deri më tani. Këtu kemi të bëjmë me shkelje të praktikave dhe kemi të bëjmë edhe me shkelje të vendimit të OSHP-së i cili është lëshuar ekskluzivisht për këtë lëndë. Trajtimin e sqarimit të referencave e ka bërë plotësisht në kundërshtim të plotë me nenin 69, dhe 72 të LPP-së, në kundërshtim me interpretimin e KRPP-së si dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së. Trajtimin e pretendimit lidhur me automjetet e ka bërë në kundërshtim të plotë me nenin 69 të LPP-së si dhe në kundërshtim të plotë me vendimin e OSHP-së. Ndërsa trajtimin e pretendimit lidhur me vendosjen e emrit të OE që tashmë AK e ka shpallur fitues në dosjen e tenderit tek deklarata nën betim të dosjes së tenderit e ka bërë në kundërshtim me të gjitha dispozitat e LPP-së, RRUOPP-së por e ka bërë edhe në kundërshtim me të gjitha parimet e mira për trajtimin e rasteve të tilla në prokurimin publik. Ky trajtim duket të jetë injorues, tendencioz por edhe qesharak. Trajtimi i përgjithshëm i ankesës është në kundërshtim të plotë me praktikat e deritanishme të OSHP-së pasi që në asnjërin nga pretendimet nuk është përgjigjur veç e veç se a është apo jo i bazuar. Bazuar në të gjitha këto që i thamë më lartë, kërkojmë nga Kryetari i OSHP-së, z. Blerim Dina që para se të mbahet seanca e shqyrtimit kryesorë, ta obligoj Ekspertin Shqyrtues që edhe njëherë ta trajtoj ankesën tonë duke u bazuar në faktet e ofruara nga ne, në dispozitat e LPP-së, interpretimet e KRPP-së si dhe në vendimin e më hershëm të OSHP-së. Ne mbetemi me shpresë se Paneli Shqyrtues do të veproj drejt për parandalimin e kësaj shkelje të AK-së por edhe të Ekspertit Shqyrtues, dhe gjatë trajtimit të lëndës në seancën kryesore do ti shoshis argumentet dhe faktet e dorëzuara nga ne dhe pretendimet tona do ti aprovoj si të bazuara. Nisur nga kjo kërkojmë nga Paneli Shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lëndën kthej në rivlerësim. Sinqerisht, Amazona Hotel SH.P.K.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", se AK e ka eliminuar me arsyetimin tek kërkesat 9.1&9.2 (Kapacitetet teknike profesionale), nr. 11, që ka të bëjë me kuzhinieret, inxhinierin e diplomuar të teknologjisë së ushqimit, etj.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "OE duhet të dëshmoj stafin profesional min 4 kuzhinierë (2 nga kuzhinieret të jenë të kualifikuar Diploma dhe 2 për gjellëbërës) ne fushën e gastronomisë dhe min 1 Inxhinier të Diplomuar te teknologjisë se ushqimit Master apo Bachelor". Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: "Listën e stafit profesionale vulosur dhe nënshkruar nga OE, duke ofruar dëshmi për secilin kuzhinier dhe gjellëbërës dhe Inxhinier te Teknologjisë Ushqimore. Kopjet e Diplomave për Kuzhinier, për Gjellëbërës dhe për inxhinier, CV, kopja e kontratave të punës ose para kontrata me emër te projektit në fjale".

Operatori ekonomik ankues N.T.P "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", me ankesë ka ofruar një dëshmi ku ju ka drejtuar me një kërkesë për sqarim Qendrës Kombëtare për Njohje të Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Republikës së Kosovës, e cila qendër i kanë kthyer përgjigje: "Natyrisht që titulli Gjellëbërës hynë në kategorinë e diplomës për Kuzhinier", shih më poshtë komunikimin dhe përgjigjen.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se kërkesë e njoftimit për kontratë dhe në dosjen e tenderit është: ***"(2*** nga kuzhinieret të jenë të kualifikuar Diploma dhe 2 për gjellëbërës)". Pas analizimit të dëshmive të ofruara në dosjen e tenderit, dëshmive të ofruara në letrën sqaruese, si dhe duke u bazuar në sqarimin e ofruar nga OE ankues, të bërë Qendra Kombëtare për Njohje të Diplomave pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave të Republikës së Kosovës, i cili sqarim është i cekur në ankesë, mund të merret i mirëqenë ky sqarim. Paneli shqyrtues në vendimin PSH. nr.475/20, të dt:21.08.2020, e ka udhëzuar AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, me qëllim të sqarimit dhe verifikimit /klasifikimit të certifikatave (diplomave) të kuzhinierëve dhe gjellëbërësve konform ;oigjit Nr. 04/L-138.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: "Operatori ekonomik duhet të ofroje listën për kontratat të natyrës se njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, në raste të konzerciumit Lideri duhet të këtë kontrata të shërbime së paku 60% të vlerës të shërbimeve të kërkuara (shërbime- përgatitje dhe servime te ushqimit), me institucione publike apo privat gjate tre (3) vitet e fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimum në vlerë min 950,000.00 €". Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: "Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të natyrës se njëjtë në fushën e shërbimeve - gastronomisë, gjate tri viteve te fundit (nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, minimum tri referenca pozitive duke ju bashkangjitur listës se kontratave. Lista e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik, Ne rast konzerciumi lideri duhet ti ketë në emër të OE referencat me vlerë 60% të dëshmuara me referenca te suksesshme, në kopje në rast konzerciumi, të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritetet përkatëse, për shërbimet e pranuara, te cilat

duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës, datën e nënshkrimit të kontratës, natyrën e shërbimeve dhe vendin e realizimit të shërbimeve. a. Kur shërbimi i është bërë për një autoritet publik në Kosovës ose ne një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohen certifikata e pranimit ose referenca (ne referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga autoriteti i tillë. b. Kur shërbimi është bere për një blerës privat, duhet të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga blerësi i tille. Vërejtje Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive për kryerjen e shërbimeve ose raportet e pranimeve të shërbimeve".

Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë me dt:24.09.2020, nga OE ankues NTP "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", për referencat e cekura tek Letra standarde për tenderuesin e eliminuara, ku deklaron se nuk ka marr asnjë sqarim, këto referenca për të cilat AK-së, deklarohet se ka kërkuar sqarime shtesë dhe për të cilat nuk ka marr sqarime shtesë janë të prezantuar si dëshmi më lartë. Operatori ekonomik ankues NTP "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", deklaron se AK-së gjatë vlerësimit herën e parë dhe sqarimit të tenderëve na ka kërkuar që të ia dërgojmë në kopje fizike të gjitha dëshmitë që i kemi dorëzuar si të skanuara në tenderin tonë. Disa prej dëshmive kemi hezituar të ja dërgojmë sepse janë materiale shumë sensitive (diploma të viteve para 1999) dhe në rast të dëmtimin apo humbjes së tyre, mundësia e pajisjes prapë me të tilla është zero. Pavarësisht kësaj ne ia kemi ofruar si origjinale në shikim ndërsa si të noterizuara në posedim, por Zyrtari Kryesor i Prokurimit (ZKP) si duket nuk u mjaftuaka me kaq. Përpos kësaj prapë ka kërkuar nga disa kompani që ne kemi pasur referencat e tyre mbi realizimin me sukses të projekteve e që i kemi paraqitur edhe në listën e kontratave ku nga to ka kërkuar transaksione bankare, fletëpagesa dhe dëshmi të ngjashme edhe pse këto nuk kanë qenë kërkesa të dosjes së tenderit. Bazuar në këtë OE ju ka drejtuar KRPP-së me një kërkesë për interpretim, dhe këtë interpretim e ka ofruar si dëshmi, ku ndër të tjera thuhet se:

Te nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 te Ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotesuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar ne pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron si ne vijim:

Paragrafi 3 i nenit 56 te LPP-se percakton:

"3. Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose perjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonje kerkese ose kriteri qe nuk eshte i cekur ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit".

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të lartcekur, në asnjë mënyrë AK nuk i lejohet të diskualifikojë ndonjë OE për ndonjë dëshmi që nuk është specifikuar në dokumentet e tenderimit.

Per te gjithe operatoret ekonomik qe pretendojne se AK nuk ka bere vleresimin e tendereve ne perputhje me kerkesat e specifikuara ne dokumentet e tenderit, si dhe ne perputhje me dispozitat e LPP-se dhe legjislacionit dytesor, LPP ka parapare mjetet juridike per t'i atakuar vendimet e AK-se (nenet 108/A dhe 109 te LPP-se).

Me respekt,
Arbnora Cakolli-Luzha,|
Kordinatore e Departamentit te Rregullave-KRPP.

Po ashtu nga OE ankues N.T.P "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", me dt:03.07.2020, është bërë kërkesë për Interpretim tek KRPP, shih interpretimin më poshtë:

Gmail

Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>

Kerkese per interpretim te kerkeses per sqarim nga AK - parashtruar nga AMAZONA HOTEL SHPK

Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>
To: Hotel Amazona <info@hotelamazona.com>

Wed, Jun 3, 2020 at 10:43 AM

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP sqaron dispozitat e LPP-së dhe të legjislacionit dytësor si në vijim:

Sipas nenit 59 të LPP-së, vlerësimi i tenderëve është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e autoritetit kontraktues.

Në përputhje me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së, ***"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*** *Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tendent ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tendent; me kusht që, çfardo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve".*

Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton:

"3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur ne njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tendent".

Sipas paragrafit 3 të nenit 56 të lartcekur, në asnjë mënyrë AK nuk i lejohet të diskualifikojë ndonjë OE për ndonjë dëshmi që nuk është specifikuar në dokumentet e tenderimit.

Në përputhje me paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së, *"Autoriteti kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga operatori ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit".*

Bazuar në dispozita e lartcekura, për tu konsideruar një tender i përgjegjshëm tenderi në fjalë duhet të jetë në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Në rast se gjatë procesit të vlerësimit, AK konstaton se OE nuk ka ofruar ndonjë dëshmi në përputhshmëri me atë që është kërkuar në dokumentet e tenderimit, ka të drejtë që në përputhshmëri me paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së të kërkojë sqarime me shkrim nga OE, dhe ne rast se dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar ka të drejtë të kryej një kontroll efektiv të dokumentacionit të tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit tek pika b. është kërkuar të dorëzohet certifikata e pranimit ose referenca (në referenca te jete e cekur vlera e shërbimeve) te lëshuara nga blerësi i tille. Siç shihet në kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë si dëshmi janë kërkuar të dorëzohen Certifikata e pranimit ose referenca. Në nenit 59.2 të LPP-së thuhet: "Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose

pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues". Duke pasur parasysh që referencat e ofruara nga OE ankues, ku një pjesë janë më të vjetra se tri vite, përfshirë periudhën e njoftimit për kontratë, si dhe një numër i këtyre referencave përveç ushqimit kanë të bëjnë me akomodim në dhoma të Hotelit. Bazuar në Interpretimet e dt:03.07.2020, të bërë nga KRRP-ja, i cili interpretim është kërkuar nga OE ankues NTP "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", pjesa e fundit e interpretimit të KRPP-së, është bërë duke u thirrur në paragrafin 2 të nenit 59 dhe nenin 72 të LPP-së. Interpretimi ndër të tjera thekson: "AK-së në rast se dyshon në ndonjë informacion të dorëzuar, ka të drejtë të kryej një kontrolle efektivë të dokumentacionit të tenderit".

Andaj, me rastin e kërkesës për sqarime shtesë nga AK-ja për Referencat e cekura më lartë ka vepruar konform neneve 59 dhe 72 të LPP-së dhe pa sqarimin e këtyre referencave OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit min e vlerës prej 950,000.00€, si dhe 60% të referencave si lider i konsorciumit. Andaj, duke marrë për bazë edhe Vendimin PSH.nr 475/20, të dt:21.08.2020, ku krejt në fund Paneli shqyrtues obligon AK-së, që gjatë rivlerësimit të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, të dhëna në konstatime sipas pretendimeve. Pra, AK i ka kërkuar sqarime shtesë për pretendim, siç ishin Diplomat e Kuzhinierëve dhe Kontratave dhe referencave të ofruara nga OE ankues.

Në lidhje me pretendimin tjetër të OE ankues "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se kërkesë e dosjes së tenderit dhe e njoftimit për kontratë është: OE duhet të ofroj dëshmi: • Automjet i mbyllur min 2 cope. në emër të OE. • Pajisjet e nevojshme për ruajtje dhe transport të ushqimit në teren (termoset) minimum 6 cope për ushqime. Ndërsa tek Dëshmia dokumentare është kërkuar: Lista e mjeteve Dëshmitë

• Libreza e regjistrimit të automjeteve me validitet si dhe fotografit- kopje

• Fotografit me përshkrim të pajisjeve për bartjen e ushqimit- kopje.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", në dosjen e tenderit e ka ofruar Listën e pajisjeve, ku në këtë listë janë gjithsejtë gjashtë (6) pajisje, me libreza të regjistrimit, si dhe kontratën mbi dhënien e automjeteve me qira, të lidhur me 01.06.2019, në mes me "APETIT SH.P.K" dhe "AMAZONA HOTEL SH.P.K", dhe të gjitha këto pajisje janë të pronësi të "APETIT SH.P.K", ku Paneli Shqyrtues sqaron se eksperti i ka bashkangjitur në raport evidencën e automjeteve.

Duke pasur parasysh kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ku kërkohet "Automjet i mbyllur min 2 cope. në emër të OE", operatori ekonomik ankues NTP "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", nuk e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit sepse automjetet janë në emër të "APETIT SHPK", ndërsa është kërkuar të jenë në emër të OE, askund nuk është kërkuar që automjetet të merren në huazim. Po ashtu në lidhje me këtë kriter OE në fjalë ka mundur të bëjë ankesë gjatë fazës së tenderimit.

Paneli shqyrtues sqaron AK na ka njoftuar se ka karkuar nga OE ankues për vazhdimin e validitetit të ofertës dhe OE ankues nuk është përgjigjur brenda afatit kohor që e ka bërë kërkesën AK-ja por e ka dërguar vazhdimin në mënyrë elektronike mbas 10 dite dmth me 23.11.2020 si dhe në deklaratën e ka lëshuar të nënshkruar dhe vulosur me datë 13.11.2020 ku bijën ndesh me kërkesën e AK-së.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Amazona Hotel sh.p.k & Faton Haziraj B.I", deklaron se me vet faktin se në dosjen e tenderit të publikuar në e-prokurim herën e parë tek deklarata nën betim e ka vendosur vet emrin e OE "Global Parajsa", nënkupton se përgatitjen e tenderit e kanë bërë së bashku me këtë OE e që në kushte normale do të ishte argument i mjaftueshëm për hetim të bashkëpunimit të tyre. Dëshmia që e ka ofruar OE, ku pretendon se ndodhet në dosjen e tenderit të publikuar më 11.09.2019 nga AK-ja. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në e-prokurim ekzistojnë dy dosje të tenderit, njëra e ka dt:04.02.2020 ora 11:13 dhe tjetra e ka dt: 04.05.2020 ora 12:25. Emri NTP "GLOBAL PARAJSA", tek Deklarata nën Betim, është i shënuar në Dokumentin shtojca e dt. 24.02.2020, ndërsa tek Dosja e Tenderit të dt. 04.05.2020, nuk ekziston emri dhe ky pretendim nuk ka të bëjë me kritere kualifikuese, si dhe ky pretendim nuk ka qenë në periudhat e më hershme. Ndërsa sa i përket pretendimit se në Deklaratën nën betim, AK e ka vendosur vet emrin e OE "Global Parajsa", e ku nënkuptohet se përgatitjen e tenderit AK-së e ka bërë së bashku me këtë OE, e që në kushte normale do të ishte argument i mjaftueshëm për hetim të bashkëpunimit të tyre, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se kjo çështje ka mundur dhe mund të adresohet në organet kompetente të hetuesisë.

Paneli Shqyrtues duke pasur parasysh ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Akademia e Kosovës për siguri Publike";

1x1 OE "Amazona Hotel SH.P.K & Faton Haziraj B.I "Obiliq;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.